



Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

Parimi: Qasja e bazuar në gjini duhet të jetë pjesë e të gjitha proceseve të Ballafaqimit me të Kaluarën BmK

Studim i rastit



Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërlihen me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit¹. Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kryesore që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Qasja e bazuar në gjini duhet të jetë pjesë e të gjitha proceseve të Ballafaqimit me të Kaluarën BmK”.

Qasja e bazuar në gjini duhet të jetë pjesë e të gjitha proceseve të Ballafaqimit me të Kaluarën BmK

Një qasje e bazuar në gjini duhet të ndërtohet në themel të të gjitha nismave të Ballafaqimit me të Kaluarën. Ata/o që kanë mandat dhe mision për të punuar me gra dhe burra që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore dhe dhunë seksuale gjatë konfliktit në Kosovë, duhet të synojnë të përmirësojnë jetën dhe mirëqenien e tyre. Stigma ndaj të mbijetuarve/ave të dhunës seksuale nga konflikti duhet të kundërshtohet në të gjitha mënyrat e mundshme.

Hyrje

Dhuna seksuale dhe dhuna në bazë të përkatësisë gjinore është shkelje e të drejtave njerëzore². Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, dhuna në baza gjinore nënkupton “të gjitha aktet e dhunës që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike, sociale apo ekonomike në baza gjinore, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim, apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo ndodh në jetën publike apo private³”.

Qytetarët kanë pak njohuri për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës mbi baza gjinore apo dhunë seksuale gjatë konfliktit, duke përfshirë këtu edhe mungesën e informacioneve sa i përket viktimave të gjinisë mashkullore. Në shoqëri në përgjithësi mbizotëron ideja se si viktimat të dhunës seksuale njihen vetëm viktimat e gjinisë femërore. Tema e dhunimeve dhe krimeve të tjera të ngjashme të cilat kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës së luftës konsiderohet si tabu dhe si rezultat viktimat direkte të këtyre krimeve e kanë të vështirë të dëshmojnë për shkak të stigmatizimit ndaj tyre.

Në diskursin publik flitet për viktimat e dhunës seksuale, ku pretendohen të jenë afërsisht 20,000 femra të dhunuara gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Por në fakt ky numër nuk është i verifikuar por megjithatë ai si i tillë përdoret vazhdimisht si nga personat me pozita të larta shtetërore, ashtu edhe nga ana e qytetarëve.

¹ Principi ALB (yih-r-ks.org)

² Dhuna seksuale dhe dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore ndaj refugjatëve, të kthyerëve dhe personave të shpërngulur intern, direktivat për parandalim dhe reagim, maj 2003, komesariati i lartë i kombeve të bashkuara për refugjatë, Faqe 10, Maj 2003, <https://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain/opensslpdf.pdf?reldoc=y&docid=4fcd4fc2>

³ Ligji nr. 05/L-020, për Barazi Gjinore, Neni 3, Pika 1.18, Faqe 3, 2015, [LIGJI NR. 05/L-020 PËR BARAZI GJINORE](#)



Viktimat dhe të mbijetuarit/mbijeturat e dhunës mbi baza gjinore apo edhe dhunës seksuale gjatë konfliktit, vazhdojnë të ndihen të paragjykuar për të rrëfyer në lidhje me përjetimet e tyre. Ata janë riviktimizuar si nga shoqëria ashtu edhe nga familjet e tyre, si pasojë e stigmatizimit, duke qenë se ajo çka u ka ndodhur atyre konsiderohej e turpshme për t'u kuptuar nga të tjerët. Ky stigmatizim ka bërë që ende sot, ne të mos jemi në dijeni lidhur me numrin dhe përqindjen e saktë të të gjithë atyre të cilët janë prekur nga forma të tilla të dhunimeve gjatë periudhës së konfliktit në Kosovë.

Në vazhdim të kësaj analize do të mund të vihet re shembulli i mirë të cilin e kanë dhënë si organet shtetërore ashtu edhe organizatat e ndryshme joqeveritare drejtë realizimit të njohjes së viktimave të dhunës seksuale dhe ofrimit të ndihmës ndaj tyre. Padyshim që veprime të tilla paraqesin precedente të cilat duhet të ndiqen, për shkak të rezultateve pozitive të cilat ato i kanë dhënë.

E drejta e viktimave në njohje dhe përfitim të statusit

E drejta e viktimave të dhunës seksuale për të përfituar statusin e tyre dhe të drejtat e beneficioneve nuk është njohur menjëherë pas përfundimit të luftës. Kjo kategori e viktimave ka qenë fillimisht e përjashtuar nga ligji (Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre) i cili u jepte statusin kategorive të ndryshme të viktimave e poashtu edhe beneficioneve respektive. Që statusi i tyre të gëzonte njohje, është dashur të avokohet në mënyrë që kjo kategori e viktimave të njihet dhe në këtë mënyrë të gëzojë beneficioneve të cilat ligjërisht do të duhej t'i takonin.

Sipas një publikimi të bërë nga ana e Amnesty International me titull “Plagë që të djegin shpirtin” ndër tjerash thuhet se “Ligjet e vendit, brenda mundësive, (duhet) t’ia mundësojnë një viktime që ka përjetuar dhunë ose traumë që të përfitojë nga vëmendja e veçantë dhe përkujdesja për të shmangur ri-traumatizimin gjatë procedurave ligjore dhe administrative të përcaktuara për të vendosur drejtësi dhe ofruar shpërblim⁴”.

Qëllimi i ligjit të lartcekur të nxjerrë në vitin 2011 ishte “përcaktimi i statusit, përkrahja financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtar për lirinë dhe çlirimin e vendit⁵”. Por në këtë ligj nuk ishte përfshirë një nga kategoritë më të ndjeshme të cilat janë prekur nga krimet e kryera në vend, gjatë periudhës së luftës, përkatësisht viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Ky lloj përjashtimi përbën diskriminim për këto viktime, duke pasur parasysh nivelin e stigmës ndaj tyre, kjo kategori më së shumti kishte pasur nevojë për përkrahje, duke përfshirë përkrahjen ligjore, me qëllim të njohjes së vuajtjeve dhe lehtësimin e qasjes në drejtësi.

Në vitin 2011 kur edhe ishte nxjerrë ligji në fjalë, në krye të shtetit ishte Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga. Ajo kishte bërë përpjekje të rëndësishme për të njohur të drejtat dhe vuajtjet e viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit nëpërmjet themelimit të Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë konfliktit. Ky këshill ishte themeluar në mars të vitit 2014 dhe i njëjti ka përfunduar mandatin në mars të vitit 2016. Këshilli Kombëtar kishte pasur mandat në lidhje me reparacionet, njohjen ligjore dhe qasjen në drejtësi, mbështetjen ekonomike dhe fuqizimin, kujdesin shëndetësor ndaj viktimave të kësaj kategorie dhe ndërjegjësimin për të trajtuar stigmën dhe diskriminimin⁶.

Mirëpo sa i përket avokimit në ndryshimin e ligjit, i cili paraqitej si diskriminues për kategorinë e viktimave të dhunës seksuale, kontribut të rëndësishëm kishin dhënë organizatat e ndryshme joqeveritare. Thirrje publike i ishte bërë deputetëve të Kosovës nga ana e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), në mënyrë që të përkrahin ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre duke shtuar si kategori të veçantë “personat e dhunuar gjatë luftës”. Kjo letër ishte dërguar me arsyetimin se një gjë e tillë “do të ofronte njohje, fund të stigmatizimit dhe rikthim të dinjitetit. Pasi që dhuna seksuale është përdorur si armë e luftës, atëherë gratë duhet të trajtohen si të gjitha viktimat e luftës.” RrGGK gjithashtu kishte adresuar edhe letra të ndryshme, së bashku me grupe të tjera të shoqërisë civile, me të njëjtën kërkesë⁷.

RrGGK poashtu kishte organizuar një protestë me moton “Nuk duam lule por duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës.” Në këtë protestë u kërkuar publikisht mbrojtje ligjore për gratë e dhunuara gjatë luftës⁸.

⁴ Amnesty International, Plagë që të djegin shpirtin, <https://www.amnesty.org/en/wp-content/uploads/2021/05/EUR7075582017ALBANIAN.pdf>

⁵ Ligji nr. 04/l-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3305>

⁶ UNDP, Ballafaqimi me të Kaluarën dhe Pajtimi në Kosovë: Një përmbledhje e institucioneve dhe iniciativave, Dokument punues, 2017, Prishtinë, https://www1.undp.org/content/dam/kosovo/docs/TJ/ALB_TJ%20Summary%20of%20Institutions%20and%20Initiatives.pdf

⁷ Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 19.03.2014, Prishtinë, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/11/20140319161908203.pdf>

⁸ Koha.net, 19 mars 2014, <https://archive.koha.net/?id=27&l=3491>



Kërkesën e RrGGK e kishte përkrahur edhe Amnesty International, organizatë kjo e cila kishte kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që të garantojë të drejtat e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Sipas vlerësimit të Amnesty International ishte thënë se këto viktima ndjenin midis tjerash pasiguri, turp, ndjenjë fajësie, depresion dhe mosbesim dhe se për pasojë, atyre u është mohuar qasja në ndihmë psikologjike, ekonomike, shëndetësore dhe forma të tjera rehabilitimi⁹. Si rezultat i avokimit të parreshtur nga të lartpërmendurat, propozimi i tyre kishte kaluar me sukses në Kuvendin e Kosovës, ku edhe i njëjti u hodh në votim nga ana e ish kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi.

Prandaj me vendim të marrë nga mbledhja plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më datën 20 mars 2014, u miratua Ligji me numër 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre¹⁰, me ç'rast edhe në titullin bazik ishte shtuar fjalia “viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës”¹¹.

Sipas këtij ligji si viktimë e dhunës seksuale konsiderohet personi i/e cili/a i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27.02.1998 deri më 20.06.1999. Gjithashtu është përcaktuar se afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesës për realizimin e të drejtave të viktimave të dhunës seksuale të jetë 5 vite nga fillimi dhe zyrtarizimi i punës së Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës¹². Për një gjë të tillë gjatë dëgjimit publik të thirrur nga Komisioni për Shëndetësi para miratimit të ligjit, Feride Rushiti nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) kishte thënë se kjo periudhë do të duhej të mirrej në konsideratë për zgjatje¹³.

Komisioni zyrtarisht ka caktuar datën 5 Shkurt 2018 për fillimin e procesit të aplikimit¹⁴, ndërsa viti 2023 është viti i fundit kur edhe viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë mund të parashtrajnë kërkesat e tyre me qëllim të njohjes dhe përfitimit të të drejtave dhe beneficioneve të tjera të cilat janë të parapara me ligj.

Statusi i personave të dhunuar gjatë luftës kalon nëpër procesin e njohjes dhe verifikimit, në të cilin viktimat duhet të dorëzojnë dokumentet të cilat provojnë krimin i cili është kryer ndaj tyre. Ky proces realizohet përmes Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës, i themeluar më 28 prill të vitit 2017¹⁵, i cili i përcakton kushtet dhe kriteret të nxjerra përmes akteve nënligjore të Qeverisë.

Me kërkesën e FDHK në qershor të vitit 2021 drejtuar Sekretarisë së Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, është dhënë numri i viktimave të cilave iu është njohur statusi i viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Në përgjigjen zyrtare të Sekretarisë së këtij Komisioni, thuhet se “deri më tani¹⁶ 37 meshkujve u është njohur statusi viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës dhe i përfitojnë beneficinet e përcaktuara për këtë kategori. Procesi i aplikimit është duke u zhvilluar normalisht. Ndërsa sa i përket gjinisë femërore, deri më tash statusi viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës i është njohur 922 aplikueseve.”

Feride Rushiti nga QKRMT, në një intervistë për KultPlus, ndër tjerash kishte thënë se “heshtja dhe stigma rreth dhunës seksuale në kohë lufte dhe paqe, në njëfarë forme ka mbrojtur dhunuesin për të mos marrë dënimin e merituar, duke përforcuar më tej paragjykimet sociale”¹⁷.

Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, gjithashtu ndihmohet nga 4 organizata jo qeveritare, të cilat janë të licensuara me qëllim të dhënies së ndihmës rreth njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Ato organizata janë: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Medica Gjakova, Medica Kosova, si dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG), të cilat kanë për mision dhënien e ndihmës për këtë kategori të personave¹⁸.

⁹ Radio Evropa e Lirë, 19 mars 2014, <https://www.evropaelire.org/a/25302739.html>

¹⁰ Radio Evropa e Lirë, 20 mars 2017, <https://www.evropaelire.org/a/25303799.html>

¹¹ Ligji nr. 04/L-172 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, 2014, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436>

¹² Ligji nr. 04/L-172 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, 2014, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2793>

¹³ Kallxo.com, 12.06.2013, <https://kallxo.com/gjate/viktimat-e-dhunimit-te-dallohen-nga-viktimat-civile/>

¹⁴ Udhëzues për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, Faqe 17, <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/udhezues-per-procesin-e-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-personave-te-dhunuar-gjate-luftes-clirimtare-te-kosoves-pdf/?wpdm=4850&ind=VURIw4taVUVTIFDDi1lgUFJPQOVTSU4gRSBOSk9ISkVTIERIRSBWRVJRkILSU1JVCBUw4sgU1RBVFVTSVQgVMOLIFBUIINPTkFWRSBUw4sgREHVTIVBUiBHSkFUw4sgTFVGMOLUyDDh0xJUKINVEFSRSBUw4sgS09TT1bDi1MucGRm>

¹⁵ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 28.04.2017, [Themelohet Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Personave të Dhunuar gjatë luftës – MPMS \(rks-gov.net\)](https://www.rks-gov.net/Themelohet-Komisioni-Qeveritar-për-Njohjen-dhe-Verifikimin-e-Personave-të-Dhunuar-gjatë-luftës-MPMS)

¹⁶ Qershor 2021

¹⁷ KultPlus, 03.04.2018, <https://www.kultplus.com/intervista/feride-rushiti-dhuna-seksuale-e-luftes-ka-gene-njera-prei-heshtjeve-te-medha-te-historise-son/>

¹⁸ Udhëzues për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, Faqe 16, <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/udhezues-per-procesin-e-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-personave-te-dhunuar-gjate-luftes-clirimtare-te-kosoves->



Studim i rastit

Komisioni përmes rrjeteve sociale ka njoftuar të gjitha viktimat të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale që do të aplikojnë për pranimin e statusit të tyre si viktimë, që do të garantojë konfidencialitetin e plotë të aplikuesve dhe rasteve të tyre, e që në asnjë mënyrë nuk do t'i bëjë të ditura për opinionin e gjerë të dhënat e ofruara në aplikacion. Gjithashtu ky Komision i kishte bërë thirrje të gjitha institucioneve dhe shoqërisë që të trajtojnë këtë plagë të luftës me ndjeshmërinë e nevojshme e me dinjitet të lartë njerëzor, duke respektuar viktimat dhe familjarët e tyre¹⁹.

Pa ndihmën e organizatave dhe funksionimin e duhur të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës do të ishte i vështirë procesi i njohjes e përfitimit të statusit të viktimave dhe fuqizimi i të drejtave të tyre.

Në vitin 2018 QKRMT ka hartuar “Udhëzuesin për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës”, në bashkëpunim me akterë të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë, me qëllimin kryesor që viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë të informohen për të gjitha të drejtat të cilat i garantohen me ligj, procedurën e aplikimit dhe të gjitha kriteret e nevojshme për aplikim. Sipas këtij udhëzimi synohej harmonizimi dhe koordinimi në mes mekanizmave institucional, organizatave joqeveritare në lidhje me njohjen statusit, referimin tek ofruesit e shërbimeve, mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë²⁰.

Me gjithë sfidat e mëdha ndër vite, organizatat e grave vitin 2018 e kanë konsideruar si vit historik për kauzën e të mbijetuarave, duke e quajtur “Viti i njohjes së statusit të viktimave të dhunës seksuale²¹.”

Gjithashtu, sipas Dr. Denis Mukwege, laureati i Çmimit Nobel për Paqe për vitin 2018, në takimin të cilin ai kishte marrë pjesë, të pritur nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë luftës “modeli i Kosovës do të shërbejë si model edhe për vendet e tjera që kanë kaluar situata të ngjashme në konflikte të armatosura²²”.

Përkundër faktit se veprimet e të gjithë akterëve të lartpërmendur kishin pasur ndikim të madh drejt realizimit të të drejtave të viktimave të dhunës seksuale, megjithatë mund të vërehej edhe fryma e paragjykitimit ndaj kësaj kategorie. Përgjatë procesit të avokimit nga aktivistë e organizata të ndryshme, paragjykitimet shoqërore për këtë kategori gjithmonë kishin qenë të shprehura haptazi. Këtë e dëshmon në mënyrë reale kërcënimi që i ishte bërë një ndër aktivisteve më të zëshme e cila kishte avokuar për njohjen e kësaj kategorie të veçantë të viktimave të luftës.

Aktivistja për të drejtat e njeriut Nazlie Balaj, kishte qenë caku kryesor i sulmit, e cila personalisht në derën e banesës së saj kishte pranuar një letër kërcënuese me tekstin e shkruar në të “t’lutemi mos e mbrojë turpin, se të pret plumbi në ballë²³”.

Përpos që ligjërisht kjo kategori duhet të gëzojë njohje, sikur edhe të gjitha kategoritë e tjera të viktimave, në të njëjtën kohë duhet të parandalohen veprimet e tilla kërcënuese si dhe stigmatizuese ndaj tyre.

Për një veprim të tillë ndaj aktivistes kishte reaguari Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë së bashku me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, të cilët kishin shprehur shqetësimin për kërcënimin e bërë ndaj Nazlie Balajt²⁴. Por për fat të mirë kjo frymë paragjykyese luftohet nga shumë organizata të cilat në kuadër të fushëveprimtarive të tyre kanë mision të përmirësojnë jetën e viktimave të dhunës seksuale.

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=400707637443335&id=343412826506150

¹⁹ Facebook Post, 2019, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=400707637443335&id=343412826506150
²⁰ Udhëzues për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, Faqe 7, <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/udhezues-per-procesin-e-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-personave-te-dhunuar-gjate-luftes-clirimtare-te-kosoves-pdf/?wpdm=VURIw4taVUVTFDDi1JgUFJPOQVTSU4gRSBOSk9ISkVTIERIRSBWRVJJKILSU1JVCBUw4sgU1RBVFVTSVQgVMOLIFBUIINPTkFWRSBUw4sgREHVTIVBUiBHSkFUw4sgTFVGMOLUyDDh0xJukINVEFSRSBUw4sgS09TT1bDi1MucGRm>

²¹ Koha.net, 19.06.2018, <https://www.koha.net/arberi/100095/hellip-duam-dreitesi-per-grate-e-dhunuara-gjate-luftes/>

²² Koha.net, 11.11.2019, [Nobelisti për Paqe lavdëron modelin e Kosovës për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë luftës - KOHA.net](https://www.koha.net/arberi/100095/hellip-duam-dreitesi-per-grate-e-dhunuara-gjate-luftes/)

²³ Telegrafi, 21.03.2013, <https://telegrafi.com/letra-ndaj-aktivistes-balaj-mos-e-mbroje-turpin-se-tpret-plumbi/>

²⁴ YIHR KS, <https://yih-ks.org/denohet-kercenimi-me-vdekje-ndaj-aktivistes-se-te-drejtave-te-njeriut-zni-nazlie-balaj/>



Rekomandime

Në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën²⁵”, të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Sipas ligjit për për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, si viktimë e dhunës seksuale konsiderohet viktimë që i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27.02.1998 deri më 20.06.1999, prandaj rekomandojmë që kjo periudhë të zgjatet, së paku deri në vitin 2000, për shkak se edhe pas datës së përmendur krimet e kësaj natyre mund të kenë ndodhur si pasojë e luftës në Kosovë.

Sipas ligjit për për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, thuhet se afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave për realizimin e të drejtave të tyre është 5 vite nga fillimi dhe zyrtarizimi i punës së Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e personave të dhunuar gjatë luftës. Andaj rekomandojmë që edhe ky afat të zgjatet edhe më tej, në mënyrë që t’u ipet kohë shtesë viktimave për parashtrimin e kërkesave të tyre.

Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.

²⁵ [Principi ALB \(vibr-ks.org\)](http://PrincipiALB.org)

 [@dwpkosovo](https://www.facebook.com/dwpkosovo)

 [@dwpkosovo](https://www.instagram.com/dwpkosovo)

 [@dwpkosovo](https://twitter.com/dwpkosovo)

 [dwpkosovo](https://www.youtube.com/dwpkosovo)